

**LIGJ**  
**Nr. 3/2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4,  
DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN DHE  
DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE  
SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA, MJETEVE  
KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE NDËRMARRJEVE”, MIRATUAR  
ME LIGJIN NR. 9967, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Neni 4 i aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndër-marrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndër-marrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 4**

Organi që kryen procedurat e shitjes së pronës shtetërore që privatizohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, është struktura përgjegjëse për shitjen e pronës publike në Ministrinë e Financave.”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.2.2015

**Shpallurme dekreten nr. 8977, datë 18.2.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**